

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësit e institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.


Aktivitetet përgjatë muajit Shtator, 2023

Finalizohet dhe mbyllet konsultimi i raportit 6-mujor 2023, i monitorimit të Planit të Veprimit Antikorrupsion

18.09.2023: Grupi Tematik Antikorrupsioni, në nivel teknik, u mbledh dhe miratoi përmbajtjen, të dhënat dhe analizën e raportit 6-mujor i parë, 2023 të monitorimit të Planit të Veprimit Antikorrupsion. Për këtë periudhë monitorimi, *janar-qeshor 2023*, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna për 60 masa e 104 aktivitete, të shpërndara përkatësisht në 32 masa e 58 aktivitete për qasjen parandaluese (A), 20 masa e 29 aktivitete për qasjen ndëshkuese (B) dhe 8 masa e 17 aktivitete për qasjen ndërgjegjësuese (C). Rezultati i analizës së raportit tregon se realizuar plotësisht 35 masa, pjesërisht 10 masa dhe nuk janë realizuar 15 masa si dhe janë realizuar plotësisht 64 aktivitete, pjesërisht 7 aktivitete dhe nuk janë realizuar 33 aktivitete. Zbatimi i Planit të Veprimit Antikorrupsion ka tregues të mirë në fushën e parandalimit dhe ndërgjegjësimit kundër korrupsionit. Politika ndëshkuese kundër korrupsionit edhe për këtë periudhë, është e ndarë midis SPAK dhe prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm me 110 procedime penale me 118 persona nën hetim nga SPAK dhe 84 procedime penale me 62 të pandehur nga juridiksioni i përgjithshëm. Raporti do të diskutohet në takimin e Grupit Tematik Antikorrupsioni në nivel të lartë drejtues, gjatë muajit tetor 2023.



RAPORTI I MONITORIMIT PËR PERIUDHËN JANAR-QESHOR 2023



Ministria e Drejtësisë pjesë e tryezës rajonale mbi promovimin e edukimit antikorrupsion



4.09.2023: Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit në vend, mori pjesë në tryezën rajonale “Promovimi i Edukimit Kundër Korrupsionit”, e organizuar nga Zyra e Kombeve të Bashkuara (UNODC) dhe financuar nga Republika Federale e Gjermanisë, që u mbajt në Becici, Mal i Zi. Kjo konferencë bëri së bashku ekspertë nga organet publike dhe sektori i shoqërisë civile nga gjashtë vendet e rajonit, përfshirë Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbinë, për të diskutuar dhe ndarë përvojat në fushën e edukimit kundër korrupsionit për të rinjtë e të gjitha grupmoshave. Kjo konferencë ishte e pasur dhe ofroi një platformë të rëndësishme për shkëmbimin e ideve dhe praktikave të mira. Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e edukimit kundër korrupsionit në formimin e një shoqërie të drejtë dhe transparente. Përmes përfaqësuesve nga Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion, Ministria e Drejtësisë shpalosi eksperiencat e saj të deritanishme në këtë tryezë, në projektet e edukimit antikorrupsion, në armin parauniversitar si dhe shprehu angazhimin e saj institucional për t'i bërë këto nisma pjesë të vizionit strategjik 2030. Ndarja e përvojave në hartimin dhe draftimin e politikave të edukimit kundër korrupsionit u shoqërua bashkërisht me diskutime mbi sfidat dhe sukseset e ndryshme në projektet e vendeve të rajonit për edukimin kundër korrupsionit. Përfshirja e të gjithë aktorëve në edukimin e të rinjve, mësuesit, prindërit dhe komunitetet lokale është e rëndësishme për të siguruar që iniciativat mbi edukimin kundër korrupsionit të jenë efikase dhe të qëndrueshme, duke kultivuar një ndjenjë të përbashkët të përgjegjësisë qytetare dhe edukimit ligjor.

Aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në 9 muajt e vitit 2023

1-30.09.2023: Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë bën një analizë të aktivitetit të saj 9-mujor (janar – shtator) 2023, në fushën e hetimeve administrative për raste korrupsionit në administratën publike. Në total, gjatë kësaj periudhe rezultojnë: 52 Raporte Përfundimtare nëpërmjet të cilave janë propozuar: 108 masa për fillimin e ecurisë disiplinore; 40 masa për largim nga detyra dhe 147 rekomandime. Vetëm për këtë periudhë janë depozituar 14 kallëzime për ndjekje penale me mbi 30 persona të kallëzuar, për raste të dyshuara të gjetjes së elementëve të veprës penale të korrupsionit. Sektorët me problematika në raste korrupsionit vijojnë të mbeten fusha e pronave, tatimeve, kontrollit të ushqimit, shërbimit postar, fushës së arsimit, etj. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit dhe mekanizmi i Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit janë pranë qytetarëve jo vetëm për rritjen e ndërgjegjësimit dhe intensifikimit të luftës kundër korrupsionit ku evidentohen problematika, por edhe me marrje dhe verifikimin administrativ në kohë, për të krijuar një mjedis më të ndershëm dhe ligjor në shërbim të qytetarëve.

Në rast se hasni praktika korruptive në përballjen me insitucionet shtetërore, denoncojini ato në:
koordinatoriak@drejtesia.gov.al



Roli i Kuvendit në frenimin e korrupsionit, si gjithëpërfshirje në strategjinë ndërsektoriale kundër korrupsionit



15.09.2023: Lufta kundër korrupsionit kërkon më shumë përfshirje dhe bashkëpunim. Për këtë qëllim u zhvillua konferenca kombëtare e një prej partnerëve shumëvjeçarë të institucioneve shqiptare, të organizatës Instituti Kombëtar Demokratik – NDI, në Tiranë. Konferenca “Roli i Parlamentit në frenimin e korrupsionit” mbledhi bashkë përfaqësues të politikës, të qeverisë, të sektorit të shoqërisë civile edhe ekspertë të jurisprudencës për të diskutuar gjetjet e raportit të zhvilluar nga NDI dhe për të ofruar mendimet e opinionet e tyre, gjithashtu. Zëvendësministri i Drejtësisë, znj. Adea Pirdeni, ishte pjesë e panelit kryesor folës në konferencë. Znj. Pirdeni pranoi rekomandimet e dhëna nga raporti duke pohuar reflektimin e tyre në dokumentin e ri të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2023-2030, dhe në planin e veprimit. Kuvendi dhe roli i tij kontrollues ndaj institucioneve qendrore dhe me kompetenca politikëbërëse dhe ekzekutuese do të ketë një rol edhe në angazhimet strategjike kundër korrupsionit, në vitet në vijim, si një reflektim dhe në ndjekje të rekomandimeve të lëna në rezolutat e dhëna prej tij. Ministria e Drejtësisë konfirmoi bashkëpunimin me partnerë të interesuar në finalizimin e këtij dokumenti, edhe si pjesë e angazhimit të saj për të rritur përgjegjshmërinë dhe transparencën institucionale kundër korrupsionit. Strategjia e re kundër korrupsionit pritet të jetë një dokument veprimi që do të rakordojë ndërhyrjet e nevojshme etike, kontrollin parlamentar dhe bashkëpunimin ndër-institucional në vend.



Prokurimet publike, deklarimi i pasurive dhe konfliktit të interesave dhe pronarët përfitues si instrumenta kundër korrupsionit, pjesë e Roadmap Antikorrupsioni

26-27.09.2023: Udhëzuesi: Antikorrupsioni dhe Financimi i Paligjshëm (*Roadmap*) referuar instrumenteve të parandalimit të korrupsionit, përkatësisht zhvillimit të prokurimeve publike, deklarimit të pasurive dhe kontrollit të konfliktit të interesave, si edhe instrumentit të pronarëve përfitues mbledhi bashkë vendet e Ballkanit Perëndimor, në Budva, Mali i Zi. Zbatimi i angazhimeve shtetërore të marra në këtë dokument, të dhëna dhe praktika të mira si dhe pritshmëritë për në vijim u diskutuan në nivel teknik nga ekspertë të Shqipërisë, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi, Bosnjës dhe Hercegovinës, Serbi e Kosovë. Ndryshimet në legjislacionet e vendeve pjesëmarrëse, ngritja dhe organizimi i strukturave dhe organeve, përdorimi i mekanizmave dhe mjeteve të kontrollit, sistemet online të prokurimeve publike dhe të pasurive, ndërgjegjësimi dhe informimi publik për mekanizimin e pronarëve përfitues u ndanë mes vendeve si një mënyrë e mirë replikimi të tyre, aty ka mundësi në vijim. Udhëzuesi: Antikorrupsioni dhe Financimi i Paligjshëm (*Roadmap*) është një produkt i Samitit të Berlinit, 2018, dhe vënë në zbatim nga zyra e UNODC për rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ky angazhim është një proces dhe pjesëmarrje për të vendosur standarde të mira dhe tematike kundër korrupsionit. Në tetor 2023, do të zhvillohet takimi i radhës për objektivin e 3 të *Roadmap*: mbi bashkëpunimin e organeve ligjzbatuese, organet me kompetenca antikorrupsioni, autoritetet policore dhe të pastrimit të parave. Ministria e Drejtësisë në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit koordinon procesin dhe raportimin e Shqipërisë, dhe garantuar pjesëmarrje dhe zbatim korrekt dhe në kohë para UNODC.



Ngrihet Rrjeti GlobE për rajonin e Ballkanit Perëndimor

5.09.2023: Ballkani Perëndimor vijon bashkëpunimin institucional dhe koordinues për të bashkënduar proceset në luftë kundër korrupsionit. Rrjeti botëror i agjencive ligjzbatuese – GlobE, është organizuar edhe në nivelin e organeve të Ballkanit Perëndimor midis vendeve Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Serbi. Organet e prokurorive të vendeve, organet hetimore, autoritetet kundër korrupsionit janë bërë bashkë në Rrjetin Globe Rajonal, me qëllimin për të rakorduar kapacitetet njerëzore, tekniko-profesionale dhe të mjeteve në përdorim për të ndarë dhe konsultuar raste dhe çështje të hetimit dhe analizës. Shkëmbimi i eksperiencave mes vendeve dhe autoriteteve në fushën e hetimeve penale do të ndihmojë hetimin e thelluar dhe përparimin e gjurmimit të krimit ekonomik dhe të korrupsionit. Të gjitha vendet pjesëmarrëse dhanë miratimin e tyre për të qenë pjesë e Rrjetit Globe Rajonal dhe dakordësuan përdorimin e komunikimit të përbashkët për nisma dhe veprime me impakt në hetimin e korrupsionit. Me pjesëmarrjen në këtë aktivitet, Ministria e Drejtësisë, ushtroi rolin e saj të institucionit drejtues kombëtar kundër korrupsionit dhe iniciator i politikave në nivel qendror. Përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë dhe teknikë të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit ishin pjesë aktive e takimit të parë të shpalljes së Rrjetit GlobE Rajonal. Rrjeti GlobE ka gjithashtu anëtarë, autoritetin e Prokurorisë së Përgjithshme dhe të SPAK.

Më shumë informacion për Rrjetin GlobE gjeni në link: <https://globenetwork.unodc.org/globenetwork/en/network/launch-of-regional-component-for-western-balkans.html>, dhe në profilet sociale të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit.

Trajnime dhe forcim kapacitetesh të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit

14, 19-21.09.2023: Stafi i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit, të përfshirë në veprimtarinë e hetimit administrativ dhe të politikëbërjes, kanë marrë pjesë në seanca trajnime të përgatitur për auditorë të agjencive antikorrupsion në vendet e Ballkanit Perëndimor. Tematika si: Monitorimi dhe Vlerësimi i Rrezikut ndaj Korrupsionit, i organizuar nga organizata rajonale për antikorrupsionin, RAI, u orientua mbi evidentimin e problematikave si dhe ndarjen e praktikave të mira në rang rajonal në këtë fushë, në aplikimin e analizës SWOT në lidhje me vlerësimin dhe monitorimin e rrezikut ndaj korrupsionit në juridiksionet specifike, si edhe monitorimit dhe vlerësimit të riskut ndaj korrupsionit në punën e përditshme, në krijimin e strategjive adekuate kundër korrupsionit, jo sipas një modeli të përgjithshëm, por duke u bazuar në problematikat specifike të një shteti. Tematika tjetër: Për mekanizmin e Rishikimit të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC), u fokusua tek aplikimi i dispozitave të UNCAC, kryerjes dhe kthimit të përgjigjeve ndaj rishikimeve, prezantimit me metodologjinë dhe mjetet e rishikimit, si dhe fuqizimit të tyre për të përsëritur sesionet e seminarit në nivel kombëtar ose rajonal dhe krijimit të një platforme për dialog konstruktiv duke shkëmbyer njohuritë ndërmjet pjesëmarrësve.

